

17 JANAR 2017

## VËSHTIRËSITË E KOSOVËS NË QEVERISJEN E KOMUNITETEVE PAKICË GJATË VITIT 2016 DHE MËNYRA PËR RINOVIMIN E AGJENDËS SË KOMUNITETEVE GJATË VITIT 2017

AUTORË: ADRIAN ZEQRIRI, TRIM KABASHI, ALEKSANDAR ARSIĆ

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) formuan një koalicion qeveritar, së bashku me një numër të partive politike të komuniteteve pakicë. Që nga filltet e kësaj qeverie në fund të vitit 2014, koalicioni i drejtuar nga kryeministri Isa Mustafa ka përjetuar kohë të vështira dhe situatë të zhurmshme politike duke marrë parasysh faktin se kjo qeveri u përpoq të adresojë agjendën më të vështirë politike në historinë e Kosovës si shtet i pavarur: duke bërë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për themelimin e Dhomave të specializuara për krime të luftës, duke përmbushur kushtet e vendosura nga BE-ja për heqjen e vizave dhe udhëtimin e lirë drejt vendeve të BE-së, në veçanti shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura me Serbinë në kuadër të dialogut të Brukselit, për të mos përmendur trajtimin e një sërë çështjesh sociale dhe ekonomike me të cilat përballet Kosova.

Qysh nga fillimi, koalicioni qeveritar është përballur me rezistencë të konsiderueshme nga partitë opozitare, kryesisht nga *Lëvizja Vetëvendosje* dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e udhëhequr nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj, i cili në vazhdimësi ka sfiduar legjitimitetin e qeverisë dhe ka bërë thirrje për zgjedhje të reja që nga ditët e para të kësaj qeverie në fund të vitit 2014.

Koalicioni qeverisës gjithashtu u përball me mosmarrëveshjet e brendshme dhe me kundërshtimin e ashpër për sa i përket çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me komunitetet në Kosovë: transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një ushtri të Kosovës, ligjin e Trepçës, Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me shumicë serbe dhe vendosjen graduale të institucioneve të Kosovës në katër komunat veriore dhe shumë sfida të ndërlidhura me funksionimin e tyre. Marrë parasysh këto sfida, marrëdhënia e qeverisë me partnerin e saj serb të koalicionit, Listën Serbe, besohet të ketë qenë

formuar nga Serbia dhe se liderët e listës konsiderohet të kenë pak ose aspak fuqi vendimmarrëse, pa pëlqimin e Serbisë<sup>1</sup>,ka qenë shumë e vështirë që nga fillimi i hershëm, me një situatë krejtësisht të përkeqësuar nga fundi i vitit që posa lamë. Përkundër këtyre rrethanave, Kosova ka gëzuar një rritje mbresëlënëse, vit-për-vit, të GDP-së/PBB-së prej 4%, dhe është anëtarësuar në organizata të rëndësishme ndërkombëtare përfshirë ato sportive, ndërsa ka vazhduar të investojë fonde dhe burime të rëndësishme për zhvillimin e katër komunave të saj veriore kryesisht të banuara me popullatë shumicë serbe. Në vijim ju paraqesim një përmbledhje të shkurtër të zhvillimeve më të rëndësishme që kanë shënuar vitin 2016 në lidhje me adresimin e çështjeve të komuniteteve në Kosovë. Analiza përfundon me një listë të rekomandimeve për qeverinë dhe aktorët e tjerë të përfshirë në Kosovë, përkatësisht BE-në dhe SHBA-në që duhet të rigjallërojnë agjendën e komuniteteve në Kosovës.

## Lista Serbe: në mes të Kosovës dhe Serbisë

*Lista Serbe* është një koalicion i partive serbe në një listë të unifikuar të organizuar dhe mbështetur nga qeveria e Republikës së Serbisë. Koalicioni përfshin edhe përfaqësues të komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë, përkatësisht Adem Hoxhën përfaqësues i komunitetit goran në Kuvendin e Republikës së Kosovës.<sup>2</sup>*Lista Serbe* ka dalë fituese në mesin e partive të komunitetit serb pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013 respektivisht atyre parlamentare të mbajtura në vitin 2014. *Lista Serbe* ka fituar nëntë nga dhjetë vendet e garantuara për komunitetin serb në Kuvendin e Kosovës,<sup>3</sup> gjithashtu ka fituar shumicën e zgjedhjeve për kryetar komunash/kuvende komunale (komuna e Shtërpcës ka qenë përjashtim, edhe pse kryetari i kësaj komune më vonë iu bashkua *Listës Serbe*). Kjo fitore, edhe pse pritej duke marrë parasysh mbështetjen e qartë dhe të zëshme të kësaj liste nga Serbia, shënoi një ndryshim drastik në skenën politike të serbëve të Kosovës, e cila deri në atë kohë ishte udhëhequr nga liderë serbë që u bënë të rëndësishëm nëpërmjet angazhimit me institucionet e Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht ishin shumë më të prirë për bashkëpunim me ta.

Sipas dispozitave kushtetuese të Kosovës për përfaqësimin e garantuar të komuniteteve pakicë në qeveri, përfaqësuesit e *Listës Serbe* u emëruan në një numër

<sup>1</sup> Bodo Weder, 'Progresi i pa mbërrimë? Tregtimi i demokracisë për zgjidhjen e kontestit të statusit në Kosovë ', f. 12-14, nëntor 2015. Në dispozicion si në vijim:<http://www.helsinki.org.rs/doc/DPC Policy Paper Trading Democracy in Kosovo.pdf>

<sup>2</sup> Deputeti goran Hoxha është shkarkuar nga koalicioni pas përplasjeve të brendshme të *Listës Serbenë* lidhje me shkarkimin e ministrit Lubomir Mariq ([http://kossev.info/strana/arhiva/srpska\\_nenad\\_rasic\\_i\\_adem\\_hodza\\_do\\_daljnjeg\\_iskljuceni\\_iz\\_poslanickog\\_kluba/10716](http://kossev.info/strana/arhiva/srpska_nenad_rasic_i_adem_hodza_do_daljnjeg_iskljuceni_iz_poslanickog_kluba/10716)).

<sup>3</sup> Njëri nga deputetët i cili në kohën e zgjedhjeve ka garuar si kandidat i pavarur nga *Lista Serbe*, Nenad Rashiq më vonë i'u bashkua listës, që sërish të largohet nga Lista në prag të përplasjeve të fundit në kuadër të listës pas shkarkimit të ministrit Mariq. ([http://kossev.info/strana/arhiva/srpska\\_nenad\\_rasic\\_i\\_adem\\_hodza\\_do\\_daljnjeg\\_iskljuceni\\_iz\\_poslanickog\\_kluba/10716](http://kossev.info/strana/arhiva/srpska_nenad_rasic_i_adem_hodza_do_daljnjeg_iskljuceni_iz_poslanickog_kluba/10716)).

të konsiderueshëm të pozitive të qeverisë, duke përfshirë edhe pozitën shumë domethënëse të Zëvendëskryeministrit, Ministrit të administrimit të pushtetit lokal dhe atë të Ministrit për kthim dhe komunitete, si dhe disa pozita zëvendës-ministore dhe pozita të tjera të rangut të lartë.<sup>4</sup>Edhe pse kjo pozitë në dukje i krijonte Listës Serbe një pozicion goxha të fortë për të ndikuar në politikëbërje dhe vendimmarrje në nivel qendror dhe atë lokal, për shkak të marrëdhënieve të saj të ngushta me Beogradin, marrëdhëniet me partitë shqiptare në qeveri kanë qenë shumë të vështira. Një sërë deklaratash kundërthënëse dhe paraqitjeve publike së bashku me politikanë të lartë të Serbisë gjatë ngjarjeve dhe manifestimeve të ndryshme, janë konsideruar të jenë të dëmshme për shtetësinë e Kosovës, kanë përkeqësuar marrëdhëniet në mes të *Listës Serbe* dhe qeverisë, dhe e kanë vënë qeverinë në thumb të kritikave të mëdha nga ana e opozitës dhe opinionit publik.

Pas bllokimit të procesit të formimit të Asociacion/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe diku nga mesi i vitit 2016 (për më shumë në lidhje me Asociacionin shihni kapitullin e ardhshëm), situata u përkeqësua, kur në tetor, qeveria miratoi ligjin për Trepçën dhe atë për Investime strategjike të cilat shumë shpejtë u futën në shqyrtim në parlament, veçanërisht Ligji për Trepçën. Këto ligje nuk ishin konsideruar si ligje me interes vital për komunitetet dhe kështu nuk u ndoqën procedurat për interesa vitale në parlament (procedura këto që kërkojnë shumicë të dyfishtë, që do të thotë, jo vetëm një shumicë të thjeshtë në parlament, por edhe shumicën e partive që përfaqësojnë komunitetet). *Lista Serbeka* kritikuar shumë ligjet e shqyrtuara që nuk kanë marrë parasysh pozitën e komunitetit serb në Kosovë. Me një paraqitje të veçantë duke dëshiruar të përdorin institucionet e Kosovës për të avancuar pozitën e tyre, *Lista Serbe* ka sfiduar Ligjin për Trepçën dhe disa ligje dhe udhëzime të tjera në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.<sup>5</sup> Gjykata ka lëshuar një vendim më 31 tetor, 2016 duke hedhur poshtë argumentin se këto ligje janë në kundërshti apo shkelje të Kushtetutës, dhe ka vënë në dukje se ligjet, veçanërisht Ligji për Trepçën “është kushtetues, si për përmbajtjen ashtu edhe për procedurën e ndjekur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për miratimin e tij.”<sup>6</sup>

Ky zhvillim është një mundësi e humbur si për qeverinë ashtu edhe për Listën Serbe për të punuar së bashku në këto çështje në përpjekje për të kapërcyer dallimet që palët kanë. Si rezultat, duke filluar në nëntor të vitit 2016, Lista Serbe zyrtarisht ka ngrirë të gjitha marrëdhëniet me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Më herët në nëntor, Ministri për administrimin e vetëqeverisjes lokale, Lubomir Mariq, është parë së bashku me Marko Gjuriq, drejtor i “Zyrës për Kosovë dhe Metohi” të Serbisë, pasi ky i fundit kishte anashkaluar ndalimin e udhëtimit të tij në Kosovë nëpërmjet rrugëve

<sup>4</sup> <http://www.dw.com/en/kosovo-chooses-new-government-after-six-month-stalemate/a-18119560>

<sup>5</sup> [http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2016&mm=10&dd=18&nav\\_category=640&nav\\_id=1189339](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2016&mm=10&dd=18&nav_category=640&nav_id=1189339)

<sup>6</sup> GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS, [Lënda Nr. KOu8/16](#) (31 tetor, 2016), “Rezoluta për papranueshmëri”, f.15.

dhe kanaleve jozyrtare. Prania e ish-Ministrit Mariq u kritikua shumë ashpër nga partitë opozitare dhe ka qenë gjerësisht e mbuluar në mediat e Kosovës.<sup>7</sup> Menjëherë pas kësaj, kryeministri Mustafa ka shkarkuar Mariqin. Është bërë e ditur më vonë se ky vendim është bërë në marrëveshje me të paktën një pjesë të *Listës Serbe*, përkatësisht atyre deputetëve që i përkasin Lëvizjes Socialiste të ministrit serb Aleksandar Vulin.<sup>8</sup> Këta deputetë, për më tepër, u kthyen në parlamentin e Kosovës. Mustafa ka zëvendësuar Mariqin me Mirjana Jevtiqin, ish- zëvendës ministre e punës dhe mirëqenies sociale.<sup>9</sup> Emërimi i Jevtiqit doli të jetë disi e diskutueshme, megjithatë, duke marrë parasysh se një pjesë e caktuar e anëtarëve të koalicionit të *Listës Serbe*—nëveçanti anëtarët e Partisë Përparimtare që udhëheq pushtetin në Serbi, duke përfshirë Mariqin dhe zëvendëskryeministrin Branimir Stojanović—publikisht kanë deklaruar se ata nuk pajtohen me këtë vendim. Më 26 dhjetor 2016, të gjithë deputetët e *Listës Serbe* në Kuvendin e Republikës së Kosovës u thirren për një takim urgjent me kryeministrin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Pas takimit, edhe Vuçiq edhe disa deputetë të *Listës Serbe* kanë lëshuar deklarata të forta dhe ultimatum drejtuar Qeverisë së Kosovës, duke i bërë thirrje ministri Jevtiq që menjëherë të japë dorëheqjenga posti i saj duke i bërë thirrje qeverisë së Republikës së Kosovës që të fillojë me themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe.<sup>10</sup> Marko Gjuriq ka thënë se serbët e Kosovës do të veprojnë drejt “themelimit të Asociacionit nga vetë serbët” nëse Kosova dështon të bëjë një gjë të tillë deri më 15 shkurt 2017.<sup>11</sup> Menjëherë pas kësaj, Jevtiq dha dorëheqjenga pozita e Ministrit të administrimit të pushtetit lokal dhe Lista Serbe përsëri iu kthye bojkotimit të punës së Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>12</sup>

## Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe: Vazhdon gjendja e bllokuar

*Lista Serbe* në vazhdimësi e paraqet Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe si një institucion që do të garantojë mbijetesën e komunitetit serb në Kosovë dhe në këtë mënyrë deklaron që Asociacioni do të jetë një çështje e një rëndësie të posaçme dhe të kamotshme për komunitetin serb që duhet të zgjidhet para adresimit apo trajtimit të çdo çështjeje tjetër.<sup>13</sup> Në këtë çështje, lista është e mbështetur nga

<sup>7</sup> <http://lajmi.net/lajmi-fundit-kryeministri-mustafa-shkarkon-ministrin-lubomir-marig/>

<sup>8</sup> Për një sqarim dhe të kuptuar më të mirë, politikanët serbë të Kosovës sipas rregullit gjithashtu janë anëtarë të partive politike serbe. Njëri krah i takon Lëvizjes Socialiste të Vulinit, tjetri i takon Partisë përparimtare të kryeministrit serb Aleksandar Vuçiq. Edhe pse Lëvizja socialiste dhe Partia përparimtare janë partnerë të koalicionit në Serbi dhe në Kosovë (si pjesë e Listës Serbe), marrëdhëniet ndërmjet të dy krahëve kanë qenë të tendosura.

<sup>9</sup> <http://www.balkan.eu/prime-minister-mustafa-discharges-minister-lubomir-maric/>

<sup>10</sup> <http://www.gazetaexpress.com/lajme/lista-srpska-leterultimatum-kryeministrit-mustafa-shkarkojeni-ministren-jevtiq-299759/>

<sup>11</sup> Data nuk është e rastësishme, që përkon me ditën e shtetësisë serbe. <http://koha.net/?id=27&l=150277>

<sup>12</sup> [http://kossev.info/strana/arhiva/mirjana\\_jevtic\\_podnela\\_ostavku/10786](http://kossev.info/strana/arhiva/mirjana_jevtic_podnela_ostavku/10786)

<sup>13</sup> <http://www.slobodnaevropa.org/a/beograd-blizi-pristini-nego-srpska-zajednica-na-kosovu/26735429.html>

Serbia, e cila në vitin 2013 nënshkroi një marrëveshje me Kosovën në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja në Bruksel që parashikonte krijimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe në Kosovë, si një mekanizëm për forcimin e autonomisë së vetë-qeverisjes lokale.<sup>14</sup> Asociacioni/Bashkësia doli të jetë një çështje e diskutueshme, megjithatë, disa përpjekje për hartimin e një projekt-statuti dështuan për shkak të mosmarrëveshjeve të shumta dhe të ashpra për mandatin dhe kompetencat e tij. Gjithashtu, ekziston edhe një kundërshtimi i fuqishëm brenda Kuvendit të Kosovës nga partitë opozitare. Një numër i deputetëve kanë parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në vitin 2015 mbi natyrën dhe kushtetutshmërinë e Asociacionit. Gjykata konstatoi se, ndërsa marrëveshja e parë e prillit të vitit 2013 është një detyrim ligjor për qeverinë e Kosovës, marrëveshja e dytë e gushtit të vitit 2015 që përshkruan hollësitë për sa i përket parimeve të përgjithshme të Asociacionit përfshin një numër elementesh që nuk janë në përputhje me kushtetutën e Kosovës. Gjykata ka theksuar se Asociacioni/Bashkësia duhet të respektojë karakterin shumetnik të shtetit dhe se në radhë të parë është një ushtrim i vetëqeverisjes lokale.<sup>15</sup> Qeveria u zotua të respektojë vendimin e Gjykatës dhe pohoi se Statuti i Asociacionit do të duhet t'i përmbahet këtij interpretimi.

*Lista Serbe* nuk pajtohet me këtë qasje dhe i ka bërë thirrje publike qeverisë që të veprojë kundër këtyre interpretimeve dhe të procedojë me themelimin e Asociacionit/Bashkësisë sipas marrëveshjes së dytë. *Lista Serbe*, për më tepër, ka parashtruar ankesa mbi Ligjin për Trepçën dhe Ligjin për investimet strategjike, për të cilat ligje *Lista Serbe* pretendon se janë projektuar për të penguar krijimin e Asociacionit/Bashkësisë.<sup>16</sup> Ndërsa Gjykata hodhi poshtë këto ankesa, *Lista Serbe* vazhdon t'i bëjë presion partnerëve të saj të koalicionit për të miratuar Statutin e Asociacionit/Bashkësisë duke hapur rrugën për krijimin e tij.

Gjatë periudhës së verës, BE-ja ka vendosur ratifikimin e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi si një nga kushtet që Kosova duhet të plotësojë për të fituar liberalizimin e vizave dhe udhëtimin e lirë në vendet e BE-së. Si rezultat i kësaj, çështja e demarkacionit të kufirit shpejt u bë njëri nga prioritet më të larta politike për Kosovën. Dy çështjet, demarkacioni i kufirit dhe krijimi i Asociacionit/Bashkësisë, u bënë tema të opozitës kundër qeverisë, duke rezultuar në një periudhë prej rreth tre muajve të akuzave, përlëshjeve dhe përplasjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mes të deputeteve të opozitës dhe të koalicionit qeverisës. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha komunitetet pakicë, duke përfshirë edhe Listën Serbe, në përgjithësi qëndruan

<sup>14</sup> “[Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve](#)”, 19 prill, 2013.

<sup>15</sup> Për një përmbledhje të vendimit të Gjykatës, shih ECMI KOSOVA, ‘[Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Asociacioni/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe](#)’ (28 janar, 2016).

<sup>16</sup> [http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2016&mm=10&dd=18&nav\\_category=640&nav\\_id=1189339](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2016&mm=10&dd=18&nav_category=640&nav_id=1189339)

mënjë. Përçarjet brenda politikës dhe shoqërisë kosovare në përgjithësi ndikuan që Asociacioni të lihet mbrapa në axhendën politike.

## Zhvillimet pozitive gjatë vitit

Në një vit të karakterizuar me përplot sfida serioze për stabilitetin dhe qeverisjen e shtetit, ka pasur disa zhvillime pozitive të cilat tregojnë një ndryshim gradual në qëndrimin lidhur me integrimin dhe bashkëpunimin midis institucioneve dhe komuniteteve pakicë, veçanërisht serbëve të Kosovës.

Katër komunat veriore (Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan) kanë marrë pjesë në zgjedhjet komunale në qershor të vitit 2014, duke zgjedhur kryetarët dhe kuvendet komunale. Në këto zgjedhje ishte hera e parë që qytetarët nga këto katër komuna kanë dalë në zgjedhje të organizuara nga Komisioni qendror i zgjedhjeve të Kosovës. Detyra e vështirë e integritit dhe bashkëpunimit, megjithatë, është karakterizuar me disa mosmarrëveshje për sa i përket buxheteve përkatëse komunale dhe kompetencave. Gjatë viteve 2015-2016, të katër komunat kanë rritur kontaktet dhe raportet e tyre me Ministrinë e administrimit të pushtetit lokal (MAPL) dhe buxhetet e miratuara ishin në përputhje me Ligjin për vetë-qeverisjes lokale dhe me rregulloret e nivelit qendror mbi buxhetet komunale. Qeveria e Kosovës, në përputhje me kërkesat e komunave, ka ofruar fonde për shërbimet dhe nevojat e infrastrukturës në përputhje me numrin e popullsisë së komunave dhe nevojave të identifikuar. Një total prej 14,474,233 €—euro është siguruar nga Qeveria e Kosovës për projektet kapitale në këto katër komuna gjatë vitit 2016, shumë kjo që nuk përfshin investimet direkte nga ministritë në rrugë rajonale, transport, infastrukturë, etj.<sup>17</sup>

Fondi i zhvillimit për veriun, i themeluar në përpjekje për të siguruar fonde shtesë për infrastrukturën dhe projektet socio-ekonomike në katër komunat veriore nëpërmjet taksave dhe tarifave të tjera doganore të mbledhura në pikat kufitare në veri, ka vazhduar të sigurojë fonde të konsiderueshme për këto komuna. Nga mesi i vitit 2016, një total prej dhjetë milionë euro ishin mbledhur dhe grumbulluar në Fondin e Zhvillimit, nga të cilat më shumë se 7 milion ishin shpërndarë për komunat veriore për nevojat e tyre kapitale dhe socio-ekonomike.<sup>18</sup>

Ndaras me fondet zhvillimit për veriun, donatorët ndërkombëtarë kanë vazhduar të investojnë shuma të konsiderueshme të fondeve në katër komunat veriore gjatë viteve të fundit. Bashkimi Evropian, donatori më i madh në Kosovë që nga viti 1999, ka investuar rreth 54.5 milionë €—euro, duke mbuluar 124 projekte që nga viti 2010 në një sërë fushash të tilla si: zhvillimi ekonomik, bujqësia, mbështetja dhe fuqizimi i

<sup>17</sup> LIGJI NR. 05/L-109 [PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 05/L-071 PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2016](#), 14 KORRIK 2016.

<sup>18</sup> [https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/7235/700000-euro-awarded-to-two-projects-in-northern-kosovo-municipalities-from-development-fund\\_en](https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/7235/700000-euro-awarded-to-two-projects-in-northern-kosovo-municipalities-from-development-fund_en)

organizatave jo-qeveritare dhe në fushën e infrastrukturës.<sup>19</sup> Që nga viti 2013, Bashkimi Evropian ka filluar të mbështesë drejtpërdrejt qeveritë lokale në veri të Kosovës nëpërmjet dy skemave të granteve të dizajnuara për të përmirësuar zhvillimin ekonomik dhe atë infrastrukturor: Skema e Granteve për Veriun e Kosovës I dhe Skema e Granteve për Veriun e Kosovës II. Nëpërmjet këtyre dy skemave, Bashkimi Evropian ka dhënë 9,503,637 €—euro për një total prej 79 projekteve zhvillimore të katër komunave veriore.<sup>20</sup>

Edhe pse u kushtohet vëmendje shumë e kufizuar, këta shembuj të bashkëpunimit socio-ekonomik në mes të qeverive lokale me shumicë serbe në veri të Kosovës dhe institucioneve të Kosovës paraqesin zhvillime të rëndësishme në procesin e integritit në mekanizmat e qeverisjes lokale, në ekonominë dhe shoqërinë kosovare. Polemikë e kohëve të fundit për sa i përket ndërtimit të një “muri” (politikanët serbë të Kosovës pretendojnë që muri është një zgjidhje thjeshtë teknike për qëllime të themelit të një shëtitoreje dhe, më pas, pjesë e një strukture që do të shërbejë për ngjarjet dhe manifestime publike) në anën veriore të urës mbi lumin Ibër në Mitrovicë, duke i paraprirë hapjes së urës pas më shumë se 15 viteve të qenit i bllokuar, tregon, për më tepër se sa i brishtë vazhdon të jetë ky proces.

Vizitat e Presidentit Thaçi memorialëve të viktimave civile serbe të luftës së Kosovës në Graçanicë dhe në Gorazhdec/Pejë, më në fund, paraqesin një hap të rëndësishëm që udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë ndërmarrë drejt rritjes së përpjekjeve për të konsideruar të gjitha viktimat civile të luftës. Ndërsa vizitat e Presidentit Thaçit nuk kanë kaluar pa kritika nga partitë opozitare dhe organizatat e shoqërisë civile, duke dyshuar se veprimi i tij është një kalkulim në pritje të akuzave të mundshme nga ana e Dhomave të specializuara për krime të luftës, atmosfera e përgjithshme dhe toni ishte mjaft i butë dhe jo edhe aq i politizuar. President Vizitat e Presidentit Thaçit përfaqësojnë një moment të rëndësishëm në zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse, që nderon të gjitha viktimat e pafajshme civile dhe kujtimi për ata mbetet i përhershëm. Ky është një mesazh i rëndësishëm për të gjitha komunitetet pakicë që institucionet e Kosovës janë të gatshme dhe të vullnetshme për të nderuar dhe përkujtuar familjarët dhe miqtë e tyre, si dhe, përveç atyre që i përkasin shumicës.

Qeveria e Kosovës ka filluar një proces të verifikimit të diplomave të mbajtura nga të diplomuarit në Universitetin e Mitrovicës Veriore me qëllim të aplikimit për punë në institucionet publike ose nënshtrimin të provimeve profesionale të ofruara nga institucionet publike të Kosovës. Për këtë qëllim, Qeveria ka formuar një komision që

<sup>19</sup> INSTITUTI PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TERRITORIAL (INTER) DHE RTV MIR, ‘A po jetojmë më mirë? Efekti i investimeve në veri të Kosovës pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit’ (qershor 2016).

[http://www.regionalnirazvoj.org/upload/News/Documents/2016\\_10/Da\\_li\\_zivimo\\_bolje.pdf](http://www.regionalnirazvoj.org/upload/News/Documents/2016_10/Da_li_zivimo_bolje.pdf)

<sup>20</sup> Ibid.

ka mandat të verifikojë dhe vërtetojë këto diploma, nga të cilat rreth 170 tashmë janë verifikuar dhe të diplomuarve u janë lëshuar certifikata. Ky zhvillim është bazuar vetëm në iniciativën e Qeverisë dhe është zbatuar vetëm në bazë të lehtësimit të ofruar nga aktorët vendorë, duke anashkaluar në tërësi procesin e dialogut në Bruksel, duke treguar në këtë mënyrë se shumë më tepër mund të bëhet kur aktorët vendorë, duke përfshirë Qeverinë, marrin përsipër iniciativën për të vepruar.

Në përputhje me marrëveshjen e Brukselit mbi gjyqësorin, integrimi i sistemit gjyqësor, më herët, të administruar nga Serbia në veri të Kosovës në sistemin gjyqësor të Kosovës është duke përparuar. Gjyqtarët, prokurorët dhe stafi mbështetës janë përzgjedhur, ndërsa janë duke u bërë edhe përgatitjet fillestare logjistike. Megjithatë, mbetet për t'u parë, se deri në çfarë mase do të ndikojnë në përfundimin e këtij procesi të rëndësishëm zhvillimet e fundit politike. Një pengesë e madhe që mund të vonojë procesin është dështimi i Serbisë për të miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore në ligjet e veta për gjyqësorin që të lirojë nga detyra e tyre gjyqtarët, prokurorët dhe stafin mbështetës në kuadër të sistemit gjyqësor paralel të drejtuar nga Serbia.

## Rinovimi i Agjendës për Komunitete gjatë vitit 2017

Mosmarrëveshjet themelore në mes të dy partnerëve shqiptarë të koalicionit, PDK-së dhe LDK-së, me Listën Serbe kanë penguar seriozisht punën e qeverisë dhe kanë ngadalësuar zbatimin e agjendës së saj, sidomos pasi që e njëjta lidhet me pjesët kryesore të legjislacionit siç janë demarkacioni i kufirit me Malin e Zi dhe themelimi i Asociacionit/Bashkësisë. Përveç kësaj, dialogu në Bruksel është në një krizë të qartë. Jo vetëm që zbatimi i marrëveshjeve është i ngadalshëm, por, janë vënë në pikëpyetje qëllimi bazë dhe mekanizmi pas dialogut. Ky bllokim apo ngërç mund të sinjalizojë se është koha për të për të shqyrtuar zhvillimet e fundit dhe marrë një vendim të përbashkët mbi bashkëpunimin e ardhshëm politik në mes të përfaqësuesve politikë të shqiptarëve dhe serbëve brenda Kosovës dhe procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë mënyrë, ECMI Kosova dëshiron të rekomandojë si në vijim:

- Që nga formimi i qeverisë në fund të vitit 2014, ka pasur polemika të vazhdueshme publike për sa i përket përgjegjësisë në punë dhe besnikërisë së ministrave serbë të Kosovës dhe zyrtarëve të tjerë të lartë publikë. Ata shpesh janë parë duke i shoqëruar përfaqësuesit politikë serbë në Kosovë dhe rregullisht udhëtojnë në Beograd për takime me Kryeministrin serb. Kjo krijon konfuzion ose paqartësi të mëdha në skenën politike të Kosovës dhe tek publiku kosovar në përgjithësi, pasi që ata janë parë si politikanë jo besnikë. Ekziston nevoja për rregulla të qarta rreth këtyre çështjeve. ECMI Kosova më parë ka sinjalizuar për këtë problematikë sapo ishte formuar qeveria, por problemi vetëm sa është përkeqësuar. Ministrat e qeverisë dhe zyrtarët e tjerë publikë duhet të jetë në dijeni për nevojën për të dalluar në mes të



deklaratave të tyre në cilësinë e personave juridikë si ministra dhe zyrtarë, dhe pozicionet e tyre politike si liderë apo anëtarë të partive politike.<sup>21</sup>

- Kosova, Serbia dhe BE-ja duhet të vlerësojë dhe konfirmojnë një set të parimeve themelore në bosht të dialogut të Brukselit. Këto parime duhet të përcaktojnë dialogun e Brukselit si një mekanizëm për të thjeshtësuar mosmarrëveshjet mbi çështjet më herët të diskutuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Duhet të respektohen nga të dyja anët, në mënyrë që të shmangen situatat ku çdo marrëveshje e re është e diskutueshme për shkak të sovranitetit, duke dërguar në vonesa të gjata të zbatimit ose edhe inicimit të marrëveshjeve të reja për të sqaruar marrëveshjen fillestare.

- *Lista Serbe*, dhe të gjitha komunitetet e tjera pakicë dhe përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e dhe në qeverinë e Kosovës, duhet të vazhdojnë të përdorin institucionet dhe mekanizmat e ndryshëm, të tilla si Gjykata Kushtetuese dhe klauzolën e interesit të posaçëm (Vital) në Kushtetutë, për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e tyre të garantuara me ligj.

- Themelimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe është aktualisht proces i bllokuar dhe asnjëra nga palët nuk është e gatshme të lëviz nga pozicionet aktuale. Kosova këmbëngul se Asociacioni/Bashkësia nuk mund të themelohet përderisa Serbia vazhdon të financojë strukturat paralele ilegale dhe nuk bën asgjë për të zhbërë ato. Në anën tjetër, Serbia dhe përfaqësuesit politikë të serbëve të Kosovës vlerësojnë se Asociacioni/Bashkësia është jetik për mbijetesën e komunitetit serb në Kosovë dhe se duhet të themelohet përpara trajtimit të çdo çështjeje tjetër. ECMI Kosova ka kryer një studim kërkimor për modelet e mundshme të Asociacionit/Bashkësisë që kanë për qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në nivel lokal nëpërmjet një asociacioni të komunave me shumicë serbe.<sup>22</sup>

- Asociacioni duhet të vendoset në korniza si një ushtrim i bashkëpunimit ndërkomunal në pajtim me frymën institucionale të qeverisjes në Kosovë e cila parashikon vetëqeverisje të gjerë dhe bashkëpunim ndërkomunal si mekanizëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë por duke garantuar funksionalitetin e shtetit të Kosovës.

- Komunitat pjesëmarrëse mbeten njësitë themelore të vetëqeverisjes dhe ato duhet të krijojnë mekanizma të llogaridhënies që kanë për detyrë kontrollimin dhe përcjelljen e punës së Asociacionit, si dhe të kenë mundësinë për t'u tërhequr nga Asociacioni në çdo fazë apo kohë.

- Asociacioni duhet të jetë një trup ndërkomunal me status ligjor të një asociacioni në përputhje me ligjet e Kosovës. Asociacioni do të koordinojë interesat e komunave pjesëmarrëse në fushën e demokracisë lokale, ekonomisë lokale,

<sup>21</sup> ECMI KOSOVA, 'Farkimi i një mjedisi pune brenda qeverisë së Kosovës' (18 January 2015).

<sup>22</sup> ECMI KOSOVA&PAX FOR PEACE, 'Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe: Kalimi i udhëkryqit' (qershor 2016).

arsimit, shëndetësisë parësore dhe dytësore dhe të përkujdesjes sociale; planifikimit urban dhe rural, kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë, hulumtimet dhe zhvillimet, si dhe kulturës.

- Komunat pjesëmarrëse duhet të themelojnë institucione të përbashkëta publike në mënyrë që bashkërisht të ushtrojnë kompetencat e komunave kur bëhet fjalë për arsimin në gjuhën serbe, shëndetësinë dhe kujdesin social, si dhe kulturën, siç përcaktohet me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal. Këto institucione të përbashkëta publike duhet të jenë të lidhura ngushtë me por të pavarura nga Asociacioni si trup ndërkomunal.

- Ndikimi i Asociacionit në qeverisjen në nivel qendror duhet të jetë i kufizuar dhe i integruar në mekanizmat ekzistues për përfaqësim të komuniteteve në nivelin qendror, në veçanti në Këshillin Konsultativ për Komunitete.

- Në një kohë me një agjendë shumë të vështirë politike, çështja e demarkacionit me Malin e Zi u shndërrua papritmas në njërën nga çështjet më përçarëse politike dhe publike të vitit 2016, me pasoja serioze për çështje më të rëndësishme dhe prioritare për Kosovën. Deri tani, nuk ka ekzistuar ndonjë mosmarrëveshje mes Kosovës dhe Malit të Zi për kufirin. Vendimi i BE-së për ta kushtëzuar liberalizimin e vizave me demarkacion në këtë moment të zhvillimit të Kosovës kur ajo tenton t'i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë nuk duket se ka marrë në konsideratë perspektivën e gjerë të situatës dhe ka dhënë efekt të kundërt. Gjatë vitit 2016, BE i ofroi liberalizim të vizave vendeve me probleme kufitare më të mëdha dhe më të rëndësishme. ECMI Kosova ka angazhuar një ekspert ligjor për këtë temë i cili ka ofruar disa mënyra për Kosovën për të dalë nga qorrrokaku i tanishëm, secila nga të cilat ka përparësitë dhe mangësitë e veta: 1) të mohojë marrëveshjen dhe kërkojë një proces të ri të demarkacionit, gjë që mund të rrezikojë marrëdhëniet me Malin e Zi, 2) të kërkojë arbitrazh ndërkombëtar, për të cilën gjë Mali i Zi duhet të pajtohet, 3) të vendosë një “marrëveshje shfrytëzimi” me Malin e Zi, ku kjo e fundit do të pajtohet për një administrim të “butë” të zonave të prekura nga demarkacioni. Ne rekomandojmë fuqishëm që kjo çështje të trajtohet si marrëveshje e përkohshme nga ana e dy qeverive, e arritur në bisedime të sinqerta, me parime të qarta se si do të trajtohet kjo çështje në një fazë të mëvonshme të zhvillimeve. Kjo marrëveshje do të duhej ta mbyllte këtë kapitull të panevojshëm që ka helmuar zhvillimet në Kosovë përgjatë vitit 2016.

- Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë duhet të mbajnë nivelin aktual të investimeve në komunat me shumicë serbe dhe në veçanti në katër komunat veriore, pasi ky investim është dëshmuar të jetë mjaft i suksesshëm jo vetëm në rritjen dhe zhvillimin e kushteve socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës atje, por edhe në nxitjen e bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të institucioneve të nivelit lokal dhe qendror në Kosovë.

- Zgjedhjet lokale që do të mbahen gjatë vitit 2017 do të ofrojnë mundësi për të

gjithë qytetarët të votojnë për qeveritë e tyre lokale dhe për të shprehur nevojat dhe shqetësimet e tyre përfaqësuesve që do të konkurrojnë për poste publike. Komunitetet pakicë, dhe në veçanti ato në katër komunat veriore, duhet të vazhdojnë trendin e pjesëmarrjes së konsiderueshme gjatë zgjedhjeve të fundit lokale të mbajtura në vitin 2013 (një pjesëmarrje prej më shumë se 20% të trupës votuese, pas më shumë se një dekadë ku pjesëmarrja ishte pothuajse zero), dhe të marrin pjesë në këto zgjedhje edhe më shumë duke forcuar zërin dhe pozicionin e tyre në raport me përfaqësuesit e zgjedhur në nivel lokal dhe në nivel qendror.

**Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:**

[Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe: Kalimi i udhëkryqit](#)

**Qershor, 2016**

[Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe](#)

**28 janar, 2016**

[Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe: obligim apo mundësi e mirë?](#)

**17 dhjetor, 2015**

[Incidente të përsëritura në Gorazhdec: nevoja për të vepruar shpejtë](#)

**10 dhjetor 2015**

[Komunitetet pakicë në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës: A ka abuzime me sistemin e kuotave?](#)

**15 tetor, 2015**

[Për një diskutim gjithëpërfshirës mbi asociacionin e komunave me shumicë serbe](#)

**8 tetor, 2015**

[Marrëveshja e re mbi asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe: hap i rëndësishëm përpara, por jo fjala e fundit](#)

**7 shtator, 2015**

[Mosmarrëveshjet lidhur me përdorimin e gjuhëve në Kosovë si dhe implementimi i dobët i kornizës ligjore](#)

**2 gusht, 2015**

[Hyn në fuqi pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut](#)

**26 korrik, 2015**

[Mbi trendin shqetësues të incidenteve të drejtuara ndaj komitetit serb në regionin e Pejë dhe Klinës](#)

**19 korrik, 2015**

[Vivodani: Mungesa e lajmeve është lajm i mirë](#)

**2 korrik, 2015**

[Rreth incidenteve të fundit në Klinë dhe procesin e ngadalshëm të kthimit](#)

**21 maj, 2015**

[Dita memoriale e goranëve më 6 maj: Një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës](#)

**14 maj, 2015**

*Nëpërmjet **Kosovo Communities Issues Monitor**, (Monitoruesit të Çështjeve të Komuniteteve të Kosovës) ECMI Kosova monitoron, analizon dhe ofron rekomandime mbi zhvillimet dhe shqetësimet që ndërlidhen me pozicionin e komuniteteve pakicë në Kosovë, brenda kornizës së legjisllacionit ndërkombëtar dhe vendor mbi të drejtat e pakicave. Analizat e paraqitura në Monitorues janë të mbështetura në monitorimin e rregullt dhe të ngushtë të medieve dhe intervistave me palë përkatëse të interesit. Në ndërkohë që ECMI Kosova përpiqet në çdo kohë që të sigurojë informacion të saktë dhe të nuancuar për të prezantuar pikëpamjet dhe perceptimet e të gjitha palëve, objektivi apo synimi i Monitoruesit nuk është që të sigurojë mbulim gazetaresk apo paraqitje faktike, por të ofrojë një element shtesë analitikë të debatit, duke reflektuar përvojën afatgjate të ECMI Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitete pakicë në Republikën e Kosovës dhe kuadrin ekzistues ligjor të Kosovës dhe atë ndërkombëtar.*